



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Avokatisë

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDIHMËN JURIDIKE



amshc

Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

TIRANË 2011

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDIHMËN JURIDIKE

**Botimi i këtij materiali është financuar nga
Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, AMSHC**

Për këtë botim bashkëpunoi
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS

TIRANË 2011

Dizajn & Print
EDERSTUDIO.COM

Tiranë 2011

PERMBAJTJA

1 Ligj Nr.10 039, datë 22.12.2008 “Për Ndhmën Juridike”.	faqe 5
2 VENDIM “Për miratimin e formularit të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dhe dokumentat që duhet ti bashkangjiten formularit tip të kërkesës”.	faqe 16
3 VENDIM “Mbi përcaktimin e masës së shpërblimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore”.	faqe 21
4 VENDIM “Për përparësitë në çështjet që ofrohet ndihma juridike për vitin 2011 dhe 2012”.	faqe 27
5 VENDIM “Për rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmën juridike”.	faqe 30
6 VENDIM “Për kriteret e vlerësimit, format dhe standartet e kontrollit të cilesise në ofrimin e ndihmës juridike”.	faqe 37
7 Formulari i kërkesës për ndihmë juridike për çështje civile, administrative ose penale.	faqe 43
8 Formulari i kërkesës për ndihmë juridike për çështje civile, administrative ose penale për të miturit.	faqe 46

LIGJ

Nr.10 039, datë 22.12.2008

PËR NDIHMËN JURIDIKE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjerë të ligjshëm të tij.

Neni 2

Përkufizime

Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimet:

- a)** e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike;
- b)** e profesionalizmit të personave, që japin ndihmën juridike;
- c)** e cilësisë, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike;
- ç)** e ruajtjes së konfidencialitetit;
- d)** e papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

KREU II

ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Neni 3

Administrimi

Shërbimi i ndihmës juridike për individët, të dhënë nga shteti, është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Neni 4

Detyrat e Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

- a)** zhvillon politikën shtetërore;
- b)** ndihmon në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore/nënligjore, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike;
- c)** kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë;
- ç)** përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

- a)** merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e avokatëve, që do të japin këtë ndihmë;
- b)** merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët;
- c)** merr masa disiplinore ndaj avokatëve, që japin ndihmë juridike, në përputhje me ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 6

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike

1. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike është organ shtetëror kolegjal dhe ka statusin e personit juridik publik.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët njëri zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë, njëri nga Ministri i Financave, njëri nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, i katërti nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe i pesti nga organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore. Anëtari nga organizatat jofitimprurëse zgjidhet prej 4 anëtarëve të zgjedhur më sipër, nga lista e kandidatëve të propozuar nga këto organizata.
3. Mandati i anëtarëve të komisionit është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.
4. Komisioni është organ kolegjal, me kohë të pjesshme, me përjashtim të kryetarit, i cili është funksionar me kohë të plotë.
5. Asistenca teknike, logjistike dhe financiare sigurohen nga sekretariati i komisionit.
6. Komisioni organizohet dhe funksionon sipas rregullores së brendshme, që propozohet prej tij dhe miratohet nga Ministri i Drejtësisë.
7. Paga e kryetarit të komisionit është e njëjtë me pagën e zëvendësministrit, ndërsa shpërblimi i anëtarëve, struktura e komisionit, organika dhe niveli i pagave të sekretariatit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i komisionit dhe kryetar i tij

1. Anëtar i komisionit mund të zgjidhet personi që:
 - a) ka shtetësi shqiptare;
 - b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) ka mbaruar arsimin e lartë juridik, ekonomik ose menaxhim publik;
 - ç) gëzon një figurë të pastër morale dhe përgatitje të lartë profesionale;
 - d) ka një përvojë jo më pak se 5 vjet në profesion.

2. Kryetari i komisionit emërohet në detyrë me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pasi është marrë më parë mendimi i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Kryetari i komisionit duhet të ketë arsim të lartë juridik.

3. Kryetari i komisionit lirohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

4. Detyra e kryetarit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore ose private.

Neni 8

Lirimi i anëtarëve të komisionit

Lirimi nga detyra i anëtarit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike bëhet nga organi që e ka emëruar kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit;

c) dënohet me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;

ç) ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që e ka emëruar;

d) nuk merr pjesë, pa arsye, në më shumë se tri mbledhje rresht të komisionit;

dh) i mbaron mandati i qëndrimit në detyrë.

Neni 9

Fuqia detyruese e vendimeve

Vendimet e marra nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike janë detyruese për zbatim nga avokatët që japin ndihmën juridike, sipas këtij ligji. Në rast të moszbatimit të tyre, komisioni ka të drejtë të kërkojë marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve, sipas ligjit nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 10

Detyrat e komisionit

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike kryen këto detyra:

a) zbaton politikën shtetërore në dhënien e ndihmës juridike për individët;

- b)** menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti;
- c)** miraton rregullat e caktimit të avokatëve, zyrate të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse, që do të ofrojnë ndihmën juridike dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
- ç)** vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet për ofrimin, nga ana e shtetit, të ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, për t'u përfshirë në Buxhetin e Shtetit;
- d)** lidh kontratat e shërbimit me avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse, që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike;
- dh)** vendos masën e shpërblimit të avokatëve në ofrimin e ndihmës juridike ndaj individëve, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë, por, në çdo rast, shpërblimet duhet të jenë jo më të vogla se tarifat e miratuara për shërbimin e avokatisë;
- e)** paraqet, në fund të çdo viti, raportin vjetor para Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe raporton sa herë që i kërkohet;
- ë)** përcakton dhe rishikon standardet e ndihmës juridike, si dhe kujdeset për trajnimet profesionale për avokatët që japin këtë ndihmë;
- f)** bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e ndihmës juridike;
- g)** vendos kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohet cilësia e shërbimit të ndihmës juridike të dhënë;
- gj)** mban të dhëna për personat, që përfitojnë ndihmë juridike dhe boton, në fund të çdo viti, buletin statistikor për to;
- h)** merr vendim dhe urdhëron kryerjen e pagesës së avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, pas paraqitjes së dokumenteve, që përcaktohen me vendim të veçantë;
- i)** cakton përparësitë për çështjet, për të cilat ofrohet ndihmë juridike, me kufizimet e imponuara për shkak të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion;
- j)** bashkërendon sistemin e ndihmës juridike, duke përfshirë ofrimin e saj në të gjitha format.

KREU III

SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DHE PËRFITUESIT E SAJ

Neni 11

Ndihma juridike dhe përfituesit

1. Ndihma juridike nga shteti jepet nga avokatët e autorizuar, sipas këtij ligji, në kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e ndihmës juridike parësore e të ndihmës juridike dytësore.

Ndihma juridike parësore është dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.

Ndihma juridike dytësore është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile dhe administrative, si dhe të paraqitjes para organeve administrative shtetërore.

2. Ndihma juridike jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në medien e shkruar, si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve më në nevojë.

Neni 12

Format e dhënies së ndihmës juridike

Ndihma juridike jepet nëpërmjet:

- a)** sigurimit të informacionit, dhënies së këshillimeve dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë;
- b)** plotësimit të akteve juridike;
- c)** këshillimit në vazhdimësi të personave që paraqiten vetë në gjykatë;
- ç)** përfaqësimit para organeve administrative;
- d)** mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të të dyshuarit, të të akuzuarit

dhe të të dëmtuarit në procesin penal;

dh) mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të personave në çështjet civile ose administrative.

Neni 13

Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t' u përfshirë në to.

2. Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

3. Ndihma juridike mund të kërkohet para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

4. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin, që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.

5. Moszbatimi i pikës 4 të këtij neni nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike.

Neni 14

Kthimi i shpenzimeve për ndihmën juridike të dhënë

1. Në rast se përfituesi i ndihmës juridike, në përfundim të procesit gjyqësor, përfiton rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore të parapaguara, ai detyrohet t'i kthejë Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike shpenzimet e kryera nga ky i fundit, për ofrimin e ndihmës juridike në çështjen përkatëse.

2. Personi që ka përfituar ndihmë juridike, duke paraqitur të dhëna të rreme ose të pavërteta, përfshirë edhe të dhënat për gjendjen e tij financiare, është i detyruar të kthejë të gjitha shpenzimet e kryera për ofrimin e kësaj ndihme.

3. Kthimi i shpenzimeve, sipas pikës 2 të këtij neni, bëhet sipas urdhrin të lëshuar nga Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike. Urdhri i kryetarit të komisionit përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet shërbimi i përmbarimit gjyqësor për ekzekutimin e tij.

Neni 15

Ofrimi i ndihmës juridike

1. Ndhimja juridike në çështjet civile dhe administrative jepet duke pasur parasysh:

- a)** vlerën relative të ankesës apo pasurisë së përfshirë;
- b)** bazueshmërinë në ligj të argumenteve ligjore dhe pretendimeve, të cilat paraqiten në emër të kërkuesit apo përfituesit;
- c)** mundësinë e suksesit të ankesës apo të mbrojtjes;
- ç)** kompleksitetin e çështjes;
- d)** aftësinë e kërkuesit apo të përfituesit, që të vetëpërfaqësohet.

2. Dhënia e ndihmës juridike nuk refuzohet në çështjet penale, parashikuar nga pika 1 shkronja “a” dhe pika 2 e nenit 13 të këtij ligji.

KREU IV

PROCEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE

Neni 16

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për dhënie e ndihmës juridike, në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike.
2. Kërkesa për dhënie e ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe gojarisht të personi i autorizuar për dhënie e ndihmës juridike apo për caktimin e ofruesit të kësaj ndihme.
3. Rregullat e hollësishme në zbatim të pikave 1 e 2 të këtij neni, për paraqitjen e kërkesave, përcaktohen nga Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike.

Neni 17

Refuzimi i dhënies së ndihmës juridike

1. Organi, që ka të drejtën e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike, është Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike. Ndaj vendimit të kryetarit mund të bëhet ankim në Komisionin Shtetëror për Ndhimën Juridike brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.
2. Kundër vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhet ankim në gjykatën që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 18

Vendimi i refuzimit të dhënies së ndihmës juridike

1. Vendimi për refuzimin e dhënies së ndihmës juridike duhet të përmbajë:
 - a) datën dhe vendin e vendimit;
 - b) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;

- c) formën e ndihmës juridike të kërkuar;
 - ç) arsyet e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike;
 - d) procedurën e ankimit;
 - dh) të dhëna të tjera të nevojshme.
2. Avokati i caktuar për të dhënë ndihmën juridike mund të zëvendësohet nga komisioni:
- a) nëse paraqitet kërkesa me shkrim nga vetë personi i interesuar për zëvendësimin e tij;
 - b) me kërkesë të avokatit të caktuar për dhënien e ndihmës juridike;
 - c) në rast të konfliktit të interesit.

Neni 19

Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse, të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike, japin ndihmë juridike me avokatë, duke respektuar përcaktimet e bëra në këtë ligj.
2. Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike lidh kontratë bashkëpunimi me këto organizata, për të mundësuar dhënien e ndihmës juridike, në përputhje me format dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Neni 20

Avokatët që japin ndihmë juridike

1. Ndhima juridike parësore dhe ndihma juridike dytësore jepen vetëm nga personat që ushtrojnë profesionin e avokatit.
2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike përcaktojnë listën e avokatëve që autorizohen, në përputhje me këtë ligj, të japin ndihmë juridike, si dhe vendin e shtrirjes së veprimtarisë së tyre. Nëse është e nevojshme, komisioni dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë mund të organizojnë konkurs për përcaktimin e avokatëve që do të japin ndihmë juridike.
3. Lista e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike, bëhet publike.

Neni 21

Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike

1. Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar realizohet nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike. Me kërkesë të të interesuarit, kryesisht apo me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, komisioni verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike për një rast konkret dhe, në bazë të rezultateve, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e shërbimit me avokatin e autorizuar për dhënien e ndihmës juridike.

2. Forma dhe standardet e kontrollit miratohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.

3. Rezultatet e kontrollit i dërgohen Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mund të shërbejnë si bazë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Buxheti

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe e ndihmës juridike dytësore përballohen nga Buxheti i Shtetit ose edhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Fondet për dhënien e ndihmës juridike përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.

Neni 23

Çregjistrimi i personave që lënë shtetësinë shqiptare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 7 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5997, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike

VENDIM

**“PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN
E NDIHMËS JURIDIKE DHE DOKUMENTAT QË DUHET TI BASH-
KANGJITEN FORMULARIT TIP TË KËRKESËS”**

**Në mbështetje të nenit 16, pika 1, të ligjit Nr.10039, datë 22.12.2008 “Për
Ndihmën Juridike”, me propozim të Kryetarit të Komisionit,**

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR NDIHMËN JURIDIKE**

VENDOSI

Neni 1

Personat që kërkojnë të përfitojnë ndihmë juridike duhet të paraqesin
kërkesë për dhënien e ndihmës juridike.

Kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë që kërkon dhënien e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të plotësojnë formularin tip të kërkesës, i cili përmban këto të dhëna:

Emri	
Mbiemri	
Atësia	
Amësia	
Datëlindja (dita, muaji, viti)	
Vendlindja	
Seksi	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Numri i telefonit	

Neni 2

Në rastin kur kërkuesi është i mitur ose person pa zotësi për të vepruar (i është hequr ose kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë), formulari i kërkesës së kërkuesit duhet të plotësohet nga përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë me të gjitha të dhënat për kërkuesin të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi dhe krahas tyre plotësohen edhe këto të dhëna të identitetit për përfaqësuesin e tij, të autorizuar me prokurë, si më poshtë:

Emri	
Mbiemri	
Numri dhe data e aktit që tregon cilësinë e përfaqësuesit të tij, të autorizuar me prokurë	
Organi që ka lëshuar aktin	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Shtetësia	
Numri i telefonit	

Neni 3

Tabela e të dhënave për format e ndihmës juridike të kërkuar nga kërkuesi:

Sigurim i informacionit juridik		
Dhënia e këshillave dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë		
Plotësimi i akteve të ndryshme juridike		
Dhënia e këshillave juridike për personat që e kryejnë vetë përfaqësimin në gjykatë		
Përfaqësimin e kërkuesit para organeve administrative		
Përfaqësimin e kërkuesit në gjykimin e çështjeve civile, administrative ose penale në gjykatë		

Neni 4

Formulari i kërkesës më anë të së cilës kërkuesi kërkon ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për një çështje civile apo administrative, i paraqitet Kryetarit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike nga vetë kërkuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar me prokurë.

Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike e shqyrton kërkesën brenda 15 ditëve nga dita e paraqitjes së formularit nga kërkuesi dhe vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës.

Ndaj vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhet ankim në Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike e shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së ankimit pranë tij.

Neni 5

Ndihma ligjore përjashtohet në rastet kur:

- a) kërkesa është dukshëm e pabazuar në ligj
- b) kostoja e ndihmës juridike tejkalon vlerën e çështjes

Neni 6

Formularit tip të kërkesës, për cdo rast, duhet t'i bashkangjiten këto dokumenta:

1. Fotokopje e dokumentit identifikues të kërkuarit;
2. Çertifikata familjare e kërkuarit
3. Kur kërkuari është i mitur, përfaqësohet nga një përfaqësues të autorizuar me prokurë sipas ligjit, formularit të kërkesës duhet t'i bashkangjiten:

a -fotokopja e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor, të përfaqësuesit me prokurë apo të kujdestarit

b -fotokopja e dokumentit që provon cilësinë e këtij personi si përfaqësues ligjor, me prokurë apo kujdestar (si çertifikatë e gjendjes familjare të kërkuarit, kopja e vendimit gjyqësor të formës së prerë që e ka caktuar atë kujdestar ose kopja e prokurës së përfaqësimit).

4. Dokumentat që vërtetojnë se kërkuari përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet e mëposhtme për t'u përfshirë në to:

- Nuk ka pronësi kapitale me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe tokës bujqësore

- Është i regjistruar si punëkërkuar i papunë.

Kërkuari që përfiton nga programet e mbrojtjes sociale, duhet të paraqesë dokumentin që vërteton kategorinë përfshirëse.

5. Në rast se ai plotëson kushtet për tu përfshirë në programet e mbrojtjes sociale që duhet të paraqesë për të përfituar ndihmë juridike janë:

- Vërtetim nga Zyra e Punës;

- Vërtetim nga Zyra e Tatim – Taksave;

- Vërtetim nga Zyra e Sigurimeve Shoqërore;

- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Automjeteve;

- Vërtetim nga Seksionet pranë Bashkisë nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre (urbanistika për personat me leje ndërtimi ose ndërtime pa leje, tregu i lirë, shërbimet, transportit, kulturës dhe energjetikës);

- Vërtetim nga Inspektoriati i Punës, nëse rezultojnë të punësuar informalisht.

Neni 7

Në rastin kur kërkuesi paraqet kërkesë për dhënien e ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në nenin 12 të ligjit “Për ndihmën juridike” Nr. 10 039, datë 28.12.2008, formulari tip plotësohet nga personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ose avokati vetëm për qëllime statistikore.

Në këto raste vlefshmëria e kërkesës nuk varet nga forma.

Neni 8

Personi që plotëson formularin tip të përcaktuar me këtë vendim (vetë kërkuesi ose përfaqësuesi ligjor, ai me prokurë apo kujdestari i tij) me të dhënat përkatëse të këtij formulari, ose personi që i deklaron këto të dhëna para personit zyrtar të autorizuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, e nënshkruan këtë formular tip dhe përgjigjet ligjërisht për vërtetësinë e informacionit të pasqyruar në formular dhe saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve që i bashkangjiten atij.

Neni 9

Në rast se konstatohet dhënia e informacionit të pavërtetë në formularin për dhënien e ndihmës juridike ose pavërtetësi në informacionin e dhënë në dokumentat që i bashkangjiten këtij formulari, ky fakt përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ndihmës juridike si dhe mund të shkaktojë përgjegjësi penale për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

Neni 10

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike

VENDIM

**“MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË AVOKATËVE
QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE DHE
DYTËSORE”**

**Në mbështetje të nenit 10, shkronja “dh”, të ligjit nr.10039, datë
22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”, me propozim të Kryetarit të
Komisionit,**

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR NDIHMËN JURIDIKE**

VENDOSI

Neni 1

Ky akt rregullon metodën e vlerësimit dhe të përcaktimit të masës së shpërblimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore në fushën civile dhe administrative.

Neni 2

Masa e shpërblimit për avokatët që japin ndihmë juridike parësore dhe dytësore në çështjet civile dhe administrative do të përcaktohet me pikë.

Neni 3

Vlera e Pikëve

Vlera e një pike është 1000 Lekë.

Neni 4

Dokumentat e Nevojshme

Me përfundimin e procedurave të dhënies së ndihmës, avokatët duhet të paraqesin formularin për shpërblimin për ndihmën e ofruar pranë organit kompetent. Bashkë me formularin avokatët duhet të paraqesin:

- fatura origjinale për të gjitha shpenzimet
- kopje të vendimeve gjyqësore ose administrative
- kopje të akteve juridike të kryera ku përfshihen:
 - të gjitha procedurat e ndërmarra,
 - aktet e e përpiluara,
 - pjesëmarrja në seancat gjyqësore,
 - arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore nëse ka,
 - ankimet (brenda afateve)
 - koha e shpenzuar për përgatitjen e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes,
 - mosmarrëveshjet ndërmjet avokatit dhe klientit gjatë procesit lidhur me përfaqësimin
 - mosmarrëveshjet ndërmjet avokatit dhe gjykatës
 - përmbledhje të mbrojtjes dhe rezultatet përfundimtare të çështjes
- vërtetim nëse përfituesi është i përfshire në skemën e ndihmës ekonomike
- formulari i aplikimit

Neni 5

Tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Çështje Administrative

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim dokumentash që mundësojnë hapjen e një procesi administrativ dhe dokumenta të tjerë të nevojshëm (strehime, asistencë sociale, aplikime në zyrat e gjëndjes civile, sigurime shoqërore, paaftesi për punë)	2 Pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore; (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	3 Pikë

Çështje civile pa palë kundërshtare

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim dokumentash që mundësojnë hapjen e një procesi civil pa palë kundërshtare dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	2 Pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore; (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	3 Pikë

Çështje civile me palë kundërshtare

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi civil me palë kundërshtare dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndihma gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Konflikte Pronësie

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi me objekt konflikt pronësie dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Marrëdhënie Detyrimi

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi që ka për objekt marrëdhënie detyrimi dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Dëm Jashtëkontraktor

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për shpëblimin e dëmit jashtëkontraktor dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Marrëdhënie Pune

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për ndërprerje pa të drejtë të marrëdhënieve të punës dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Të gjitha çështjet e tjera që nuk janë të klasifikuara si çështje të veçanta do të trajtohen si konflikte civile të përgjithshme me ose pa palë.

Çështje Familjare

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi me objekt konflikt në fushën familjare dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Zgjidhje Martese

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për zgjidhje martese dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Kujdestari

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për kujdestari dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Njohje Atësie/Amësie

Veprimet Juridike	Vlerësimi
1. Konsulencë dhe vlerësim i çështjes	1 Pikë
2. Hartim padie që mundëson hapjen e një procesi për njohje atësie/amësie dhe dokumenta të tjerë të nevojshme	3 Pikë
3. Ndhim gjatë procesit nëpërmjet përgatitjes së dokumentave gjyqësore (pa të drejtë përfaqësimi në gjykatë)	5 Pikë

Të gjitha çështjet e tjera që nuk janë të klasifikuara si çështje të vecanta do të trajtohen si konflikte familjare të përgjithshme.

Përfaqësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Veprimet Juridike	Vlerësimi
Përfaqësimi në gjykim për çështje civile pa palë kundërshtare	15 Pikë
Përfaqësimi në gjykim për çështje civile me palë kundërshtare	40 Pikë

- Totali i pikëve për një çështje civile pa palë kundërshtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor nuk mund ti kalojë 21 pikë.

- Totali i pikëve për një çështje civile me palë kundërshtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor nuk mund ti kalojë 49 pikë.

Ankimet

Veprimet Juridike	Vlerësimi
2. Përpilimi i ankimeve ndaj një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor	15 Pikë

Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit

Veprimet Juridike	Vlerësimi
2. Përpilimi i ankimeve ndaj një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor	15 Pikë

Rekurset

Veprimet Juridike	Vlerësimi
2. Përpilimi i kërkesës për rekurs ndaj një vendimi të Gjykatës së Apelit	25 Pikë

Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë

Veprimet Juridike	Vlerësimi
Përfaqësimi në gjykim në Gjykatën e Lartë për çështje civile me ose pa palë kundërshtare	60 Pikë

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

Veprime Juridike	Vlerësimi
Hartimi i dokumentave (Kërkesave) që mundësojnë hapjen e një procesi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë	25 Pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike

VENDIM

“PËR PËRPARËSITË NË ÇËSHTJET QË OFROHET NDIHMA JURIDIKE PËR VITIN 2011 DHE 2012”

Në mbështetje të nenit 10, shkronja “i”, të ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike, me propozimin e Kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI SHTETËROR
PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI

I. Për ndihmën juridike dytësore, rradha e prioriteteve për vitin 2011 dhe 2012 të jetë në rend zbritës si më poshtë:

- a)** çështje gjyqësore me objekt regjistrim lindje;
- b)** çështje gjyqësore për pensione pleqërie, pensione invaliditeti, pensione të parakohshme ose pagesa për personat me aftësi të kufizuar;

- c)** çështje gjyqësore për heqje zotësie për të vepruar;
- ç)** çështje gjyqësore për dhënie ndihme ekonomike;
- d)** çështje gjyqësore për vendosje kujdestarie për fëmijët ose detyrime ushqimore për ta;
- dh)** çështje gjyqësore të viktimës së dhunës në familje;
- e)** zgjidhje martese;
- ë)** çështje gjyqësore për korigjime akteve të gjendjes civile.
- f)** çështjet për të cilat Republika e Shqipërisë ka detyrim ligjor për shkak të nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare ku përcaktohet shprehimisht ofrimi i ndihmës juridike nga shteti shqiptar.
- g)** rastet e diskriminimit të referuara nga Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të detyrimeve të memorandumit të bashkëpunimit, të nënshkruar nga KSHNJ-së dhe KMD-së.

II. Për ndihmën juridike parësore, rradha e prioriteteve për vitin 2011 dhe 2012, të jetë në rend zbritës nëpërmjet dhënies së informacionit dhe këshillimit, si më poshtë:

- a)** hartim dokumentacioni për marrje ndihme ekonomike;
- b)** hartim dokumentacioni për gjendjen civile;
- c)** hartim dokumentacioni për të përfutur strehim nga shteti;
- ç)** hartim dokumentacioni për fushën e sigurimeve shoqërore, humbjen e aftësisë në punë, çështje të marrëdhënieve të punës ose zgjidhje martese.

III. Ndihma juridike parësore jepet nëpërmjet dhënies së informacionit për mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe nëpërmjet dhënies së asistencës në hartimin e dokumenteve juridike.

Ndihma juridike dytësore jepet nëpërmjet dhënies së këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore dhe para organeve administrative shtetërore.

IV. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike parashikon në marrëveshjet e bashkëpunimit që lidh me Organizatat Jofitimprurëse mbulimin financiarisht, në mënyrë të pjesshme ose tërësore, të prioriteteve të ndihmës juridike sipas këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Komisionit të marrë masat e nevojshme administrative për respektimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Kombëtare e Avokatisë
Këshilli Drejtues

VENDIM

“PËR RREGULLAT E CAKTIMIT TË AVOKATËVE, ZYRAVE TË AVOKATISË DHE ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMËN JURIDIKE”

Në mbështetje të nenit 10, shkronja “c” dhe nenit 20 të ligjit Nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”,

KOMISIONI SHTETËROR
PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI

Neni 1 **Objekti**

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurës që ndiqet për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmën juridike parësore dhe ndihmën juridike dytësore, sipas ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”

Neni 2

Parime

1. Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë caktojnë avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse për ofrimin e ndihmës juridike mbi bazën e parimeve të transparencës, konkurrencës së hapur, ofrimit të shërbimit nga më shumë se një subjekt, profesionalizmit dhe mosdiskriminimit.
2. Caktimi i avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmën juridike parësore dhe ndihmën juridike dytësore nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi numerik.

Neni 3

Njoftimi publik

1. Për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike shpall njoftimin publik, i cili duhet të botohet në tre gazeta kombëtare me tirazhin më të madh, për tre ditë rresht, si dhe në faqen e internetit të Komisionit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.
2. Njoftimi duhet të përmbajë afatin e dorëzimit të dokumentacionit i cili është 30 ditë pas ditës së fundit të botimit në gazetë, si dhe kërkesat dokumentare sipas neneve 4 dhe 5 të këtij vendimi. Avokati duhet të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike në formën e “përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative” dhe të plotësojë vetë formularin e kërkimit të ndihmës juridike të llojeve tjera, nëse ka.

Neni 4

Kriteret për avokatët dhe zyrat e avokatisë

1. Avokatët ose zyrat e avokatisë që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike duhet të kenë ushtruar profesionin e avokatisë për të paktën 2 vite.
2. Avokatët ose zyrat e avokatisë që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike duhet të paraqesin në Komisionin Shtetëror këto dokumenta:

- a) Kërkesën, në të cilën të paraqitet edhe adresa dhe numri i telefonit.
 - b) Vërtetim nga dhoma rajonale e avokatisë për përvojën në ushtrimin e profesionit të avokatit për të paktën 2 vjet.
 - c) Curriculum Vitae të avokatit apo avokatëve që përbëjnë zyrat e avokatisë së bashku me dokumentacionin provues të tyre të noterizuar.
 - d) Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve financiare ndaj shtetit.
 - e) Dy rekomandime, në të cilat të përshkruhet njëherësh eksperiencia në punë, përvoja në fushën e ndihmës juridike, cilësitë profesionale të kërkuesit, si dhe reputacioni dhe integriteti moral. Rekomandimet paraqiten në një zarf të mbyllur me nënshkrimet e rekomanduesit në pjesën e mbylljes së zarfit.
 - f) Vërtetim se avokati apo pjesëtarët e zyrës së avokatisë nuk janë deri në kohën e aplikimit në procedim disiplinor nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.
- 3.** Avokati apo zyra e avokatisë të cilit i është zgjidhur kontrata e shërbimit të ndihmës juridike nuk ka të drejtë të aplikojë.

Neni 5

Zgjedhja e avokatëve

Subjekti i cili me vendim të Komisionit kualifikohet për të përfituar ndihmë juridike ka të drejtë të zgjedhë avokatin në bazë të listës të vënë në dispozicion nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Lista përmban emrat e avokatëve sipas fushës së kualifikimit profesional si dhe dokumentat shoqërues përkatës. Avokati duhet të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative” dhe të plotësojë vetë formularin e kërkimit të ndihmës juridike të llojeve të tjera, nëse ka.

Neni 6

Kriteret për Organizatat Jofitimprurëse

- 1.** Organizatat Jofitimprurëse që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike të financuar nga shteti duhet të kenë të paktën 3 vjet përvojë në fushën e ofrimit të ndihmës juridike, të jenë të regjistruara dhe të kenë në misionin e tyre ofrimin e shërbimit ligjor.

2. Organizatat Jofitimprurëse që dëshirojnë të ofrojnë ndihmën juridike të financuar nga shteti duhet të paraqesin në Komisioni Shtetëror këto dokumenta:

- a)** Kërkesën, në të cilën të paraqitet edhe adresa dhe numri i telefonit.
 - b)** Dokumentacion që të vërtetojë ushtrimin e veprimtarisë sipas pikës 1 të këtij neni.
 - c)** Curriculum Vitae të OJF-së dhe të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike së bashku me dokumentacionin provues të tyre të noterizuar. Avokatët duhet të kenë përvojë në ushtrimin e profesionit të avokatit për të paktën 2 vjet.
 - d)** Vërtetim të dorëzimit të rregullt të bilancit të fundit vjetor.
 - d)** Dy rekomandime, në të cilat përshkruhet njëherësh eksperiencia në punë, përvoja në fushën e ndihmës juridike, cilësitë menaxheriale, ekspertiza teknike e stafit dhe korrektesia. Rekomandimet paraqiten në një zarf të mbyllur me nënshkrimet e rekomanduesit në pjesën e mbylljes së zarfit.
 - e)** Vërtetim se avokatët nuk janë në procedim disiplinor nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë deri në kohën e aplikimit.
 - f)** Një deklaratë me shkrim për vizionin e tyre për ofrimin e ndihmës juridike.
- 3.** Organizata Jofitimprurëse të cilës i është zgjidhur kontrata e shërbimit të ndihmës juridike nuk ka të drejtë të aplikojë.

Neni 7

Shqyrtimi i dokumentacionit

1. Struktura administrative e Komisionit, e ngarkuar nga Kryetari i Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, brenda 48 orësh nga mbyllja e afatit të paraqitjes së kërkesave sipas pikës 2 të nenit 3 të këtij vendimi, hap dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesit vetëm për plotësimin e elementëve formalo-juridikë sipas këtij vendimi. Në rast se këta elementë kanë të meta komunikohet menjëherë me kërkuesin për të plotësuar ato për një afat jo më shumë se 72 orë.

2. Me përfundimin e afatit, struktura e ngarkuar nga Kryetari i Komisionit paraqet relacion për plotësimin e elementëve formalo-juridikë të

aplikantëve, si dhe dokumentacionin e plotë për Komisionin Shtetëror të Ndhmës Juridike.

3. Mbledhja e Komisionit për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse për ofrimin e ndihmës juridike zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së relacionit sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 8

Klasifikimi

1. Komisioni klasifikon me pikë avokatët dhe zyrat e avokatisë që kanë aplikuar për të ofruar ndihmën juridike si më poshtë:

- a)** eksperiencën në ushtrimin e profesionit të avokatit — 40 pikë
- b)** trainimi në fushën e ofrimit të ndihmës juridike — 20 pikë.
- c)** reputacioni i mirë dhe mospasje e masës disiplinore — 20 pikë

2. Komisioni klasifikon me pikë organizatat jofitimprurëse që kanë aplikuar për të ofruar ndihmën juridike si më poshtë:

- a)** kapaciteti menaxherial dhe ekspertiza teknike — 20 pikë
- b)** eksperiencën e mëparshme në ofrimin e ndihmës juridike — 20 pikë
- c)** efikasiteti në menaxhim, (çmimi për numër çështjesh ose shërbimesh) — 40 pikë

3. Komisioni, për kategoritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni zhvillon edhe një intervistë, e cila klasifikohet me 20 pikë në vlerësimin e aplikantëve.

Neni 9

Intervista

1. Komisioni Shtetëror, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i vlerësimit sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij vendimi, zhvillon intervistë me gojë me avokatin, drejtuesin e zyrës së avokatisë dhe drejtuesin e organizatës jofitimprurëse që ka aplikuar.

2. Intervista ka si synim të mundësojë njohjen më të afërt dhe më të besueshme të aftësisë profesionale të kërkuesit, aftësisë në komunikim të tij, si dhe kapacitetit për plotësimin me cilësi dhe në kohë të detyrave

që duhet të kryhen sipas ligjit për ndihmën juridike dhe legjislacionit tjetër në fushat respektive.

3. Në përfundim të kësaj faze Komisioni plotëson pikët sipas pikës 3 të nenit 7 të këtij vendimi.

Neni 10

Shpallja e fituesve

1. Për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike aplikantët, në përfundim të procedurës së konkurimit dhe intervistës, duhet të kënë fituar jo më pak se 60 pikë.

2. Në përfundim Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike shpall me vendim aplikantët që caktohen për të ofruar ndihmën juridike së bashku me pikët përkatëse dhe fton zyrtarisht fituesit me jo më pak se 60 pikë të nënshkruajnë kontratën e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike.

Neni 11

Afati

Kontrata e shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike ka vlefshmëri kohore 2 vjet nga data e nënshkrimit të saj. Në përfundim të kësaj periudhe kohore, në varësi të rezultateve, Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike ricakton për të njëjtën periudhë avokatët, zyrat e avokatisë apo organizata jofitimprurëse, me vendim të vecantë, por pa zbatuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

Neni 12

Avokatët e caktuar kryesisht në çështjet penale

1. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë me qëllim zbatimin e kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim edhe për avokatët e caktuar kryesisht në proceset penale.

2. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike informohet dhe mbikqyr zbatimin e këtyre kriterëve për avokatët e caktuar kryesisht në proceset penale në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE E KOMISIONIT SHTETËROR
PËR NDIHMËN JURIDIKE

BLEGINA KODRA

KRYETARI I DHOMËS
KOMBËTARE TË AVOKATISË

MAKSIM HAXHIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike

VENDIM

“PËR KRITERET E VLERËSIMIT, FORMAT DHE STANDARTET E KONTROLLIT TË CILESISË NË OFRIMIN E NDIHMË S JURIDIKE”

Në mbështetje të neneve 10, shkronja (g) dhe 21, pika “2”, të ligjit nr.10039, datë 22.12.2008 “Për Ndhmën Juridike”, me propozimin e Kryetarit të Komisionit,

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR NDIHMËN JURIDIKE**

VENDOSI

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve, standarteve dhe formave për kontrollin e cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore me qëllim garantimin e standarteve më të larta të

profesionalizmit për aksesin real dhe efektiv në drejtësi, sipas ligjit nr.10039, datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”

Neni 2

Kriteret e vlerësimit të cilësisë së ndihmës juridike

Cilësia dhe efektiviteti i ndihmës juridike do të vlerësohet në bazë të përmbushjes së standarteve orientuese në aspektin kohor, cilësor dhe sasior të ofrimit të ndihmës juridike, si më poshtë :

- Koha në të cilën ofrohet ndihma juridike;
- Realizimi i mbrojtjes dhe cilësisë së saj brenda afateve të arsyeshme;
- Zgjidhja me pajtim e mosmarrë veshjeve;
- Vlerësimi dhe pranimi nga gjykata i ankimeve dhe kërkesave të përfaqësimit dhe mbrojtjes;
- Mungesa e ankimeve nga pala kundërshtarë;
- Realizimi i çështjeve komplekse me cilësinë e duhur brenda afateve të arsyeshme kohore;
- Komunikimi i mirë me klientin dhe krijimi i marrëdhënies së besimit;
- Komunikimi i mirë dhe profesional me gjykatën apo palë të treta në proces;
- Respektimi i detyrimeve ligjore të profesionit të Avokatit sipas ligjit Për Profesionin e Avokatisë, Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Kodin Etik të Avokatit;
- Frekuentimi i aktiviteteve të trajnimit të vazhdueshëm ligjor të avokatëve dhe trajnimeve specifike mbi grupet vulnerabël;
- Komunikimi, bashkëpunimi dhe raportimi tek Komisioni i Ndihmës Juridike brenda afateve kohore të përcaktuara.

Lista e kriterëve të vlerësimit të cilësisë është e rivlerësueshme në varësi të kategorisë së ndihmës juridike apo të çështjeve përkatëse.

Neni 3

Format e kontrollit të cilësisë së shërbimit

Avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore duhet të kryejnë mbrojtje dhe përfaqësim cilësor në mbrojtje të interesave të

përfituesit dhe të jenë të pajisur me njohuritë ligjore dhe kompetencën e nevojshme profesionale.

Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike të ofruar nga avokatët.

Neni 4

Kontrolli nëpërmjet vetëdeklarimit

Avokati raporton në formën e vetëdeklarimit, brenda 15 ditëve pas përfundimit të çështjes, mbi përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar midis avokatit dhe Komisionit të Ndihmës Juridike.

Bashkëngjitur Raportit të Vetëdeklarimit avokati duhet të bashkëngjisë kopjet e plota të dokumentave të çështjes përkatëse. Përpara këtij raportimi, avokati duhet t'i paraqesë Komisionit raport të ndërmjetem lidhur me ecurinë e çështjes, në përgjithësi, dhe në rast mosmarrëveshjesh me klientin apo të tjera problematika, në veçanti.

Personat e autorizuar nga Komisioni pasi shqyrtojnë Raportin e Vetëdeklarimit dhe dokumentacionin përkatës, kur e shikojnë të nevojshme - në rast të mospërputhjes midis Raportit dhe dokumentacionit apo kur ka dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e raportimit – thërrasin avokatin dhe klientin e tij për të marrë informacione të mëtejshme për plotësimin e dosjes.

Neni 5

Kontrolli kryesisht

Komisioni i ndihmës juridike nëpërmjet personave të autorizuar kryen kontrollin kryesisht të cilësisë dhe efektivitetit të ndihmës juridike të ofruar, në çështjet apo kategorinë e çështjeve, të përcaktuara në Planin Vjetor të Kontrollit, i miratuar nga Komisioni në çdo fillim të vitit kalendarik bazuar në çështjet prioritare të ofrimit të ndihmës juridike.

Kryetari dhe Komisioni i Ndihmës Juridike në varësi të indicieve apo sensibilitetit të lartë vendos kryejn e kontrolleve të paplanifikuara nga Plani Vjetor i Kontrollit. Këto kontrolle do të kryhen nga personat e autorizuar nga Komisioni nëpërmjet pjesëmarrjes në seancat gjyqësore dhe bashkëpunimit me avokatin gjatë procesit të ofrimit të ndihmës juridike. Metodat e kryerjes së kontrolleve të paplanifikuara do të përcaktohen rast pas rasti nga Komisioni.

Neni 6

Ankimet

Komisioni i Ndihmës Juridike ndjek dhe verifikon ankesat kundër avokatëve, të paraqitura nga personi i interesuar apo Ministri i Drejtësisë gjatë dhe pas procesit.

Personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike për trajtimin e ankesave regjistron pretendimet e ankuesit sipas formularit përkatës dhe kur e shikon të arsyeshme dhe të bazuar i propozon Komisionit nisjen e procedurave të kontrollit.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak, personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, përgatit relacionin e kontrollit të ankesës dhe rekomandimin përkatës, të cilin ja kalon Komisionit për verifikim dhe kontroll të mëtejshëm.

Relacioni i kontrollit i kryer nga personat e autorizuar të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike i njoftohet avokatit ndaj të cilit është bërë ankesa së bashku me rekomandimet përkatëse.

Avokati duhet të parashtrojë me shkrim pranë personelit të Komisionit argumentat dhe provat brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 7

Masat lidhur me shkeljen e kritereve ligjorë dhe cilesine e ndihmës juridike

Personat e autorizuar nga Komisioni, në varësi të rezultateve të kontrollit mbi bazë ankese apo të nisur kryesisht, përgatisin relacionin përkatës, i cili i dërgohet për shqyrtim dhe vendimarrje Komisionit. Së bashku me relacionin përkatës mbi shkeljen e detyrimeve ligjore apo konstatimit të cilësisë së dobët të shërbimit personat e autorizuar i propozojnë Komisionit këto masa:

- ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së avokatit me Komisionin;
- dërgimin e ankesës pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj avokatit;
- përjashtimin nga lista e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore.

Avokati duhet të parashtojë me shkrim pranë personelit të Komisionit argumentat dhe provat brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Komisioni gjatë shqyrtimit të raporteve të kontrollit, kur e shikon të nevojshme thërret avokatin për shpjegime të mëtejshme. Komisioni del me vendim lidhur me shkeljen e detyrimeve ligjore nga ana e avokatit dhe përcaktimin e masës përkatëse, sic parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, brenda 30 ditë ve nga regjistrimi i ankesës pranë personit të autorizuar nga Komisioni.

Komisioni i dërgon rezultatet e kontrollit pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë të Shqipërisë, e cila i trajton ato sipas parashikimeve mbi "procedurën e ankimit dhe disiplinimit të avokatëve" të Ligjit për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë, Kodit Etik dhe Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 8

Trajnimi i avokatëve të ndihmës juridike

Komisioni i Ndhmës Juridike në procesin e përzgjedhjes dhe përtëritjes së marrëveshjeve me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike do të

marrë në konsideratë, frekuentimin e pjesëmarrjes nga ana e avokatëve, në aktivitetet e trajnimit ligjor vazhdues apo trajnimet specifike mbi të drejtat e grupeve vulnerabël.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në fletoren Zyrtare.

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

Formulari i kërkesës për ndihmë juridike për çështje civile, administrative ose penale:

Personat që kërkojnë të përfitojnë ndihmë juridike duhet të paraqesin kërkesë për dhënien e ndihmës juridike.

Kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë që kërkon dhënien e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të plotësojnë formularin tip të kërkesës, i cili përmban këto të dhëna:

Emri	
Mbiemri	
Atësia	
Amësia	
Datëlindja (dita, muaji, viti)	
Vendlindja	
Seksi	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Numri i telefonit	

Tabela e të dhënave për format e ndihmës juridike të kërkuar nga kërkuesi:

Sigurim i informacionit juridik		
Dhënia e këshillave dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë		
Plotësimi i akteve të ndryshme juridike		
Dhënia e këshillave juridike për personat që e kryejnë vetë përfaqësimin në gjykatë		
Përfaqësimin e kërkuesit para organeve administrative		
Përfaqësimin e kërkuesit në gjykimin e çështjeve civile, administrative ose penale në gjykatë		

Kërkesë:

Firma

****Në rast se konstatohet dhënia e informacionit të pavërtetë në formularin për dhënien e ndihmës juridike ose pavërtetësi në informacionin e dhënë në dokumentat që i bashkangjiten këtij formulari, ky fakt përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ndihmës juridike si dhe mund të shkaktojë përgjegjësi penale për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, në bazë të dispozitave të Kodit Penal.***

Në bazë të nenit 6 të Vendimit Nr. 3, datë 25.06.2011 " Për miratimin e formularit të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dhe dokumentat që duhet ti bashkangjiten formularit tip të kërkesës", formularit tip të kërkesës, për cdo rast, duhet t'i bashkangjiten këto dokumenta:

1. Fotokopje e dokumentit identifikues të kërkuarit;
2. Çertifikata familjare e kërkuarit
3. Kur kërkuari është i mitur, përfaqësohet nga një përfaqësues të autorizuar me prokurë sipas ligjit, formularit të kërkesës duhet t'i bashkangjiten:
 - a - fotokopja e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor, të përfaqësuesit me prokurë apo të kujdestarit.
 - b - fotokopja e dokumentit që provon cilësinë e këtij personi si përfaqësues ligjor, me prokurë apo kujdestar (si çertifikatë e gjendjes familjare të kërkuarit, kopja e vendimit gjyqësor të formës së prerë që e ka caktuar atë kujdestar ose kopja e prokurës së përfaqësimit).

4. Dokumentat që vërtetojnë se kërkuksi përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet e mëposhtme për t'u përfshirë në to:

- Nuk ka pronësi kapitale me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe tokës bujqësore

- Është i regjistruar si punëkërkuks i papunë.

Kërkuksi që përfiton nga programet e mbrojtjes sociale, duhet të paraqesë dokumentin që vërteton kategorinë përfshirëse.

5. Në rast se ai plotëson kushtet për tu përfshirë në programet e mbrojtjes sociale që duhet të paraqesë për të përfituar ndihmë juridike janë:

- Vërtetim nga Zyra e Punës;
- Vërtetim nga Zyra e Tatim – Taksave;
- Vërtetim nga Zyra e Sigurimeve Shoqërore;
- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Automjeteve;
- Vërtetim nga Seksionet pranë Bashkisë nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre (urbanistika për personat me leje ndërtimi ose ndërtime pa leje, tregu i lirë, shërbimet, transportit, kulturës dhe energjetikës);
- Vërtetim nga Inspektoriati i Punës, nëse rezultojnë të punësuar informalisht.

Formulari i kërkesës për ndihmë juridike për çështje civile, administrative ose penale për të miturit:

Personat që kërkojnë të përfitojnë ndihmë juridike duhet të paraqesin kërkesë për dhënien e ndihmës juridike.

Kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë që kërkon dhënien e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të plotësojnë formularin tip të kërkesës, i cili përmban këto të dhëna:

Emri	
Mbiemri	
Numri dhe data e aktit që tregon cilësinë e përfaqësuesit të tij, të autorizuar me prokurë	
Organi që ka lëshuar aktin	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Shtetësia	
Numri i telefonit	

Në rastin kur kërkuesi është i mitur ose person pa zotësi për të vepruar (i është hequr ose kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë), formulari i kërkesës së kërkuesit duhet të plotësohet nga përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë me të gjitha të dhënat për kërkuesin dhe krahas tyre plotësohen edhe këto të dhëna të identitetit për përfaqësuesin e tij, të autorizuar me prokurë, si më poshtë:

Emri	
Mbiemri	
Atësia	
Amësia	
Datëlindja (dita, muaji, viti)	
Vendlindja	
Seksi	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa e saktë)	
Lloji i dokumentit identifikues	
Numri i dokumentit identifikues	
Numri i telefonit	

Tabela e të dhënave për format e ndihmës juridike të kërkuar nga kërkuesi:

Sigurim i informacionit juridik		
Dhënia e këshillave dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë		
Plotësimi i akteve të ndryshme juridike		
Dhënia e këshillave juridike për personat që e kryejnë vetë përfaqësimin në gjykatë		
Përfaqësimin e kërkuesit para organeve administrative		
Përfaqësimin e kërkuesit në gjykimin e çështjeve civile, administrative ose penale në gjykatë		

Kërkesë:

Firma

****Në rast se konstatohet dhënia e informacionit të pavërtetë në formularin për dhënien e ndihmës juridike ose pavërtetësi në informacionin e dhënë në dokumentat që i bashkangjiten këtij formulari, ky fakt përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ndihmës juridike si dhe mund të shkaktojë përgjegjësi penale për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, në bazë të dispozitave të Kodit Penal.***

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDIHMËN JURIDIKE